



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

10.02.2011

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 45 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit merr këtë:

**V E N D I M**

***Mbyllet rasti me nr. protokolli: AKK – 03-3516 / 10, i trajtuar për konflikt interesi për zyrtarin, Z. Rexhë Gjonbalaj – Kryesues i Bordit të Drejtorëve në PTK.***

**A r s y e t i m**

Në rastin e shqyrtuar për Konflikt Interesi, me nr. protokolli AKK-03-3516/10, është vërtetuar se ka pasur prova të mjaftueshme që argumentojnë gjendjen e konflikti të interesit, prandaj zyrtarit të lartpërmendur i është bërë shkresa njoftuese dhe nga ai është kërkuar shmangia e konflikti të interesit.

Zyrtari i lartë, brenda afatit ligjor, ka ofruar dëshmi për ndryshimet në biznes, me çka ka bërë shmangien e konflikti të interesit, ndërsa, Agjencia kundër korrupsionit ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit të DP-së
- Zyrtarit përgjegjës
- Zyrtarit ndihmës

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni

